



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1676/ 1 prot.,

Datë 27.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Edion Grup” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Instalim Panele Diellore” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Edion Grup” SHPK me NIPT L91323019S me adresa: Rruga “Kodra Diellit”, Nd. 2, Hyrja, 15, Ap. 11, Selitë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Në datë 26.06.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5482 dhe me nr. 1676/2025 Prot., date 26.06.2025 e operatorit ekonomik “Edion Grup” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Instalim Panele Diellore” me Nr. REF-45954-04-24-2025, me fond limit: 24,889,241.51 (njëzetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Edion Grup” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Edion Grup” SHPK:

- Operatori ekonomik BOE “Eidon-Grup” sh.p.k. Nipt: L91323019S & “NIGMA KONSTRUKSJON” sh.p.k. Nipt: L31626006F & “Junik” sh.p.k. Nipt: J68007522L me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë:

→ OE “NIGMA KONSTRUKSJON” ka paraqitur si staf teknik një inxhinier elektrik , por sipas ndarjes së përcaktuar në marrëveshje pasi O.E duhet të kishte 66.75% të gjith stafit teknik përderisa nuk është përcaktuar ndryshe në kontratën e bashkëpunimit sic përcaktohet në nenin 88 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

→ Nuk plotëson pikën 2.3.7 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ku thuhet : “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshjebashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet objekt prokurimi shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te saj. Ne rastin e autorizimit te distributorit duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëëbsite në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor” OE “Eidon-Grup” ka paraqitur autorizim distributori për matës elektrik , por në ndarjen e realizuar në ofertë pjesa e matësve elektrikë do kryhet nga OE “Junik”, i cili nuk ka asnjë autorizim nga distributorë apo prodhues për këtë pajisje. Për pajisjen inverter asnjë nga operatorët pjesëmarrës pjesë e BOE nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 27.06.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri